

**METODOLOGJIA
PER
HARTIMIN E PLANIT STRATEGJIK
TE ZHVILLIMIT SOCIAL-EKONOMIK
TE KOMUNES**

Pergatitur nga:

**Dr. Zef Preçi,
Qendra Shqiptare per Kerkime Ekonomike**

Prishtinë, Korrik 2007

PERMBAJTJA E LENDES

<i>Shkurtimet</i>	4
Shenime Hyrese , nga Lutfi Haziri, Zevendes Kryeminister, Minister i Administrimit te Pushtetit Lokal te Kosoves, dhe President i Asamblese se Komunave te Kosoves	5
Termt e References	6
Ne vend te hyrjes	7
Ç'fare perfaqeson Strategjia e Zhvillimit?	
Pjesa e I-re:	
PUNA PERGATITORE	18-31
I. 1 Unifikimi i Emertimit te PSZHSEK-së	18
I. 2 Shtrirja kohore e PSZHSEK-së	18
I. 3 Synimi	19
I. 4 Perberja dhe Kostituimi i Komisionit	20
I. 5 Ndryshimet ne strukturen dhe organogramen e administrates komunale	26
I. 6 Te dhena te pergjitheshme te komunes	28
I.6.1 Historiku	28
I.6.2 Shtrirja gjeografike	29
I.6.3 Popullsia	29
I.6.4 Infrastruktura	29
I.6.5 Sherbimet Publike	30
I.6.6 Arsimi	30
I.6.7 Punesimi	30
I.6.8 Profili ekonomik i komunes	31
I.6.9 Qeverisja	31
I.6.10 Organizatat jo-fitimpruese lokale dhe nderkombetare	31
Pjesa e II-te:	
DOKUMENTACIONI PERBERES I PLANIT STRATEGJIK	32-40
II.1 Vizioni dhe Qellimet	32
II.2 SWOT-Analiza e Konsoliduar (ose konkurente)	33
II.3 Matrica e Qellimeve te Planit, Objektivave, Programeve dhe Projekteve	35
II.4 Matrica e Zbatimit te Planit	36
II.5 Matrica e Prioritarizimit te Projekteve	37
II.6 Projekt Fishat	39
Pjesa e III-te:	
BASHKRENDIMI DHE KORDINIMI I PLANIT STRATEGJIK TE ZHVILLIMIT SOCIAL EKONOMIK TE KOMUNES	41-60
III.1 Bashkerendimi me Planin Kombetar te Zhvillimit	41
III.2 Bashkerendimi me Komunitat Fqinje	43
III.3 Perfitimet e Pritshme	44
III.4 Parashikimi i Shpenzimeve per Hartimin e Strategjise	44
III.5 Shtrirja e Hartimit te PSZHSEK. Kalendari i Analizave dhe i Transparences	45

III.6 Disa Rekomandime Kryesore	47
III.6.1 Rekomandime per MLGA	47
III.6.2 Rekomandime per Komunat	47
III.7 Doracaku Ndhimes i Adresave Elektronike	48
III.8 Lista e Anekseve	46
III.8.1 Model Pyetsori te Kombinuar	46
III.8.2 Model plotesimi dhe interpretimi pyetesori	54

III.8.1 Lista e Kutive

- Kutia Nr.1:** Përkufizime të zhvillimit ekonomik lokal
- Kutia Nr.2:** Politikat e zhvillimit tradicional dhe Zhvillimi Ekonomik Lokal / Rajonal
- Kutia Nr.3:** Dhjete Dukurite Politike Praktike ne Hartimin e PSZHSEK
- Kutia Nr.4:** Dhjete Principe Udheheqese per Hartimin e PSZHSEK-se
- Kutia Nr.5:** Nje praktike e mire per nje strategji te sukseshme
- Kutia Nr.6:** Model Promovimi i Resurseve te Komunes
- Kutia Nr.7:** Perfaqesues te grupeve te interesit pjesmarres ne hartimin e Planit Strategjik
- Kutia Nr.8:** Ku do te vendoset njesia per administrimin e hartimit te PSZHSEK-së?
- Kutia Nr.9:** Detyrat kryesore te Depart.te Koordinim-Zhvillimit (Karlshtad-Suedi)
- Kutia Nr.10:** Koncept Vizioni
- Kutia Nr.11:** Nje Model i Anlizes SWOT
- Kutia Nr.12:** Mbi Kuptimin e Rregulloreve dhe Vleresimin e Tyre
- Kutia Nr.13:** Disa Detyra Kryesore te MLGA ne kuadrin e hartimit te PSZHSEK-se
- Kutia Nr.14:** Disa Detyra Kryesore te Njesise se Menaxhimit te
- Kutia Nr.15:** Model mbi Zerat e Shpenzimeve per Hartimin e Strategjise
- Kutia Nr.16:** Shtrirja kohore e Aktiviteteve ne kuadrin e hartimit te PSZHSEK
- Kutia Nr.17:** Liste e Adresave Baze ne Web

III.8.2 Lista e Pasqyrave

- Pasqyra Nr.1:** Model Mbi Ilogaritjen e Koslos se çdo Projekti
- Pasqyra Nr.2:** Pasqyre Tip Mbi Listimin e Prioriteve te Projekteve
- Pasqyra Nr.3:** Pasqyre Tip Mbi Fishen e Detajuar te Projekteve

III.8.3 Lista e Skemave

- Skema Nr.1:** Pershtatshmeria e veprimtarise, zhvillimi human dhe lokal
- Skema Nr.2:** Komisioni i Hartimit te Planit Strategjik Komunal

III.9 BIBLIOGRAFI E ZGJEDHUR	55
-------------------------------------	-----------

<i>Shkurt rreth Qendres Shqiptare per Kerkime Ekonomike</i>	56
---	-----------

SHKURTIMET

ACER – Qendra Shqiptare per Kerkime Ekonomike, Tirane

ARZH – Agjensia Rajonale e Zhvillimit

DKZHK - Departamenti i Koordinim-Zhvillimit ne Komune

Kf - Koeficienti i fizibilitetit

Kn - Koeficienti i nevojës

MLGA - Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal, Kosove

MPP - Matrica e Prioritarizimit te Projekteve

MQOPP - Matrica e Qellimeve, Objektivave, Programeve dhe Projekteve

MZ - Matrica e Zbatimit

NVM – Ndermarje te Vogla e te Mesme

OBK - Oda e Biznesit Komunes

PBA - Programi Buxhetor Afatmesem

PSZHSEK - Plani Strategjik i Zhvillimit Social Ekonomik te Komunes

QL - Qeveria Lokale

QQ - Qeveria Qendrore

RP - Rezultati i Prioritetit

Shenime Hyrese

Nga Lutfi Haziri, Zevendes Kryeminister, Minister i Administrimit te Pushtetit Lokal te Kosoves, dhe President i Asamblese se Komunave te Kosoves

Te nderuar Kryetare te Komunave,

Stadi aktual ne te cilin ndodhemi, plotesimi per se shpejti i endrres se shqiptareve te Kosoves per te patur shtetin dhe qeverine e tyre te pavarur, zhvillimet ekonomike rajonale dhe ato boterore, deshira e perbashket per t'u integruar ne familjen e madhe europiane, kerkojne prej nesh me se shumti ritme te tjera te zhvillimit tone ekonomik dhe social.

Ne kete proces te veshtire, por jo te pamundur, ne te cilin ne jemi integruar prej vitit 1999, roli dhe vendi i autoriteteve lokale eshte i pazevendesueshem. Tash prej tyre eshte akumuluar nje pervoje e çmuar ne interes te komuniteteve qe perfaqesojne dhe administrojne. Por perballimi i sfidave te tranzicionit dhe te integritimit kerkon qeverisje te kualifikuar dhe menaxhim te burimeve lokale larg spontanitetit dhe efektit te “nderimit te lokomotivave” apo drejtuesve te tyre.

Duke e pare me kete pergjegjesi, Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal te Kosoves, ndermori punen pergatitore per hartimin e Planeve Strategjike per Zhvillimin Ekonomiko Social te Komunes. Realisht ne nuk shkelim ne nje terren te panjohur. Disa prej komunave tona, te mbeshetura nga donatoret dhe partneret tane perendimore, kane mundur te operojne sukseshem ne hartimin e ketyre dokumentave te rendesishme, pavaresisht se ne ate kohe, mugeonin disa dokumenta kuader, qe harmonizojne zhvillimin ekonomik kombetar shteteror me ate lokal e rajonal.

Te qeverisesh sot nje komunitet, te madh a te vogel ne numur pa Planin Strategjik te Zhvillimit Social-Ekonomik te Komunes, eshte njesoj sikur te ndermarresh nje rrugetim apo lundrim pa patur me vehte busullen dhe harten.

E veçanta e ketij procesi eshte se me manualin e “*Metodologjise se hartimit te Planit Strategjik te Zhvillimit Ekonomiko-Social te Komunes*”, na krijohen te gjithëve mundesite, por ne veçanti stafëve te komunave, per te punuar ne menyre te pavarur ne kete proces.

Me kete rast une ju siguroj gjithë mbeshetjen e Qeverise se Kosoves dhe ne veçanti te Ministrise se Administrimit te Pushtetit Lokal, nga pikepamja teknike, organizative, financiare dhe trajnuese, per ta perballuar me sukses dhe ne kohe kete proces.

Falenderoj Dr. Zef Preçin e Qendres Shqiptare per Kerkime Ekonomike (QShKE) ne Tirane, per kontributin e tij ne hartimin e ketij manuali dhe per bashkepunimin qe do te kemi ne te ardhmen.

Pune te mbare!

Lutfi HAZIZI
Zevendes-Kryeminister,
Minister i Administrimit te Pushtetit Lokal
dhe President i Asamblese se Komunave te Kosoves

TERMAT E REFERENCES

Historiku dhe argumentimi:

Gjate vitit 2006, Fondacioni per Shoqerine e Hapur Kosove dhe Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal bashkuan perpjekjet e tyre kundrejt mbeshtetjes per zhvillimin dhe konsolidimin e qeverisjes ne nivel lokal. Dhenia e mbeshtetjes per permiresimin e zbatimit te ligjit ne nivel lokal si dhe per te permiresuar planifikimin per zhvillimin lokal, ishin elementi çeles i ketij partneriteti.

Ndersa komponenti i pare konsiston ne mekanizmat per ngritjen e kapaciteteve, i dyti ne nje aktivitet kerkimi i cili do te gjeneroje nje metodologji te perbashket per te gjitha bashkite gjate hartimit te planit per zhvillimin strategjik afatshkurter dhe afatnesem. Qellimi final i komponentit te fundit eshte qe te mbeshtese zhvillimin multisektorial te bashkive te Kosoves nepermjet nje metodologjie te planifikimit strategjik tashme te permiresuar dhe te unifikuar.

Zhvillimi ne nivel lokal nuk eshte nje çeshtje te ciles nuk i eshte kushtuar vemendje ne vitet e kaluara. Perkundrazi, shume organizata kane ofruar forma te ndryshme mbeshtetjeje per bashkite e Kosoves per hartimin dhe zbatimin e planeve te zhvillimit strategjik te bashkive. Megjithate ekzistenca e larmise se planeve nuk ka lejuar nje koordinim dhe kooperim eficient te bashkive midis tyre dhe ndermjet bashkive dhe Ministrise.

Ne kete menyre Fondacioni per Shoqerine e Hapur ne Kosove dhe Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal mbeshtesin pergatitjen e nje dokumenti metodologjik dhe nje udherrefyesi (guide) mbi planin e zhvillimit strategjik te bashkive, duke u mbeshtetur ne:

- a) Konsultimin dhe analizimin e metodologjise per planin e zhvillimit strategjik ne bashkite e Kosoves deri ne 2007;
- b) Konsultimin e dokumenteve te planit per zhvillimin strategjik te prodhuara ne te kaluaren duke perfshire ketu edhe Dokumentin mbi Planin dhe Zhvillimin Strategjik te Kosoves;
- c) Konsultimin permes bashkepunimit me Ministrine e Administrimit te Pushtetit Lokal e nje numri bashkish kosovare per te zhvilluar nje analize te detajuar mbi metodologjite e planifikimit te aplikuara deri tani;
- d) Organizimin dhe pjesemarrjen ne nje vizite studimore ne nje vend te zgjedhur te rajonit.

Si i tille, dokumenti bashkengjitur shpresojme se do te sherbeje si nje ndihmese modeste ne punen e perditshme te drejtuesve dhe stafeve te tyre ne komunat e Kosoves.

Ne vend te hyrjes

Studime te ndryshme, duke perfshire edhe rajoni tone, tregojne se kushtet baze per nje veteqeverisje lokale eficiente jane: hartimi i nje strategjie te pershtatshme te zhvillimit ekonomik lokal; vullneti politik per zbatimin e saj; aftesite menaxheriale te stafeve dhe nje kuptim dhe mbeshetje publike e gjere.

Nuk ka dyshim se ne kushtet kur problemet e decentralizimit kane nje fokus shume me te gjere se sa mendohet, futja ne rrugen e zhvillimit dhe te modernizimit te fshatrave dhe qyteteve rurale te Kosoves duhet te mbeshetet fuqishem ne parimin "**Zhvillo vetevehten me resurset tuaja!**". Por a mjafton kjo?

Elementet e nevojshem per nje zhvillim ekonomik lokal dinamik jane te ndervarur njeri me tjetrin dhe pothuajse njelloj te rendesishem. Autoritetet lokale mund te arrijne t'u ofrojne qytetareve te komunes se vet sherbime publike cilesore dhe me kosto sa me te lire vetem nese krijojne kushte per lulezimin e sektorit privat, i cili mbetet burimi kryesor per sigurimin e te ardhurave te qendrueshme ne buxhetin komunal. Natyrisht, eshte nen pergjegjesine e drejtperdrejte te autoritetin te zgjedhura dhe te emeruara te komunave te Kosoves te sherbejne sa me mire qytetaret qe i kane votuar, qofte duke vendosur perparesi per llojet e sherbimeve publike qe ju sigurojne atyre, qofte edhe nepermjet perzgjedhjes se operatoreve privat lokal per ofrimin e disa prej ketyre sherbimeve.

Eshte e kuptueshme se ne periudhen qysh nga viti 1999, krahas me rivendosjen e rendit publik; ngritjen dhe ringritjen e infrastruktures baze per sherbimet jetesore ndaj qytetareve te komunave te Kosoves, krijimin e burimeve perkatese te zhvillimit, eshte lene menjane dhe ka humbur rolin e vet klasik edhe nocioni i planifikimit nga shteti apo i pritjes se zgjidhjeve problemeve ne menyre te centralizuar nga ky i fundit. Natyrisht, ky eshte nje proces qe po ndodh perdite ne syte tone dhe procesi i planifikimit ne ditet e sotme eshte bere shume me i nderlikuar, kerkon aftesi profesionale dhe dije bashkohore, informacion te gjithanshem dhe vullnet politik per te sherbyer komunitetin e qytetareve te vendit.

Pervoja e procesit te tranzicionit, gati dy dekada nga shembja e Murit te Berlinit, tregon se sukcesi apo deshtimi i reformave ekonomike varet dukshem nga shpatullat e asaj pjese te popullsisë qe paguan faturen e ketyre reformave, qe sakrifikon ne emer te nje te ardhmeje me te mire. E njejta logjike vlen edhe ne rastin e zhvillimit ekonomik lokal: puna profesionale e stafeve e sintetizuar ne strategjite e ndryshme zhvillimore arrin te perkthehet ne te mira materiale dhe shoqerore vetem nese autoritetet lokale sigurojne mbeshetjen e komunitetit ne perballimin e sfidave emergjente siç eshte ngushtimi i informalitetit dhe mbledhja e taksave; pagimi i sigurimeve shoqerore; sigurimi i mbeshetjes se mjaftueshme per shtresat dhe grupet shoqerore ne nevoje; pengimi i ndertimeve "te egra" qe pushtojne tokat urbane dhe ato bujqesore; mbrojtja e kujdesshme e mjedisit nga ndotjet industriale dhe shfrytezimi pa kriter i burimeve natyrore ne dispozicion etj. Perndryshe, kjo perkthehet si krijimi i nje kulture demokratike lokale, forcim i vlerave te komunitetit per nje te ardhme me te mire te perbashket.

Zhvillimi lokal perfaqeson nje proces shume dimensional qe synon ne permiresimin e jetes se qytetareve nepermjet shfrytezimit te burimeve lokale dhe perdorimit efektiv te kapaciteteve organizative: administrimit, menaxhimit, planifikimit dhe sherbimeve te tjera qe prodhojne "te mira" publike lokale (psh vende te reja pune), maksimizojne potencialin ekonomik, mbeshtesin inicativen e lire private dhe ofrojne sherbime publike me cilesore per qytetaret.

Pikerisht i udhehequr nga keto nocione dhe duke falenderuar Fondacioni SOROS (KFOS); Ministrine e Administrimit te Pushtetit Lokal, si dhe Forumin per Insiativa Demokratike, qe me mundesuan te njoh nga afer Kosoven dhe njerezit e mrekullueshem te saj, pranova sfiden e pergjithesimit te Strategjise se Zhvillimit Ekonomik Lokal Komunal.

Te shpresojme se jemi ne rruge te mbare...

Dr. Zef Preçi
Prishtine Korrik 2007

ÇFARE PERFAQESON STRATEGJIA E ZHVILLIMIT?

Ne ditet e sotme pranohet “*sine qua non*” se sukcesi i nje komuniteti varet nga aftesia e tij per te pershtatur zhvillimin global me ate kombetar e lokal, ekonomine e tregut kombetar dhe nderkombetar me dinamikene lokale.

Plani Strategjik i Zhvillimit po perdoret gjithmon dhe me shume per te forcuar kapacitetet ekonomike lokale te nje zone, per te permiresuar klimen e investimeve, per te rritur konkurrencen dhe produktivitetin e biznesit vendas, te ndermarjeve dhe te punonjesve. Aftesia e komunave per te permiresuar cilesine e jeteses per te krijuar mundesi te reja ekonomike dhe luftuar varferine varet nga aftesia e tyre per te kuptuar procesin e PSZH-se si dhe operimi i tyre strategjik ne nje ekonomi tregu ne ndryshim te vazhdueshem dhe shume konkuruese. Por veçanerisht i domosdoshem eshte PSZH-ja sidomos ne vendet qe vijne nga nje ekonomi e centralizuar, ku jo vetem komuniteti por as autoritetet lokale nuk i pyeste njeri se si do te zhvillohej rajoni, qyteti apo fshati i tyre.

Kutia Nr. 1

Përkufizime të zhvillimit ekonomik lokal

Zhvillimi ekonomik lokal është një përfaqje lokale e parë si partneritet dhe e planifikuar në mënyrë Strategjike me qëllim mundësimin e rritjes së punësimit, uljen e varfërisë dhe rritjen e cilësisë së jetës nëpërmjet përmirësimit të qeverisjes lokale në fushën e ekonomisë.

Agjencia Zvicerane për Zhvillimin dhe Bashkëpunimit

Zhvillimi ekonomik lokal është një koncept territorial dhe një përfaqje, e cila është e bazuar në parimet e bashkëpunimit dhe partneritetit ndërmjet të gjithë të interesuarve lokalë që operojnë në ndarjet administrative lokale. Nëpërmjet ZHEV njerëzit punojnë bashkë me ndihmën dhe lehtësirat e ofruara nga qeverisja lokale dhe nga të tjerë të interesuar të jashtëm për të arritur rritje të qëndrueshme ekonomike dhe zhvillim i cili do sjellë përmirësim të jetës së gjithkujt.

Udhëzues mbi Politikën për Zbatimin e ZHEV.

Departamenti i Provincave dhe Qeverisjes Lokale, Afrika e Jugut

http://www.dplg.gov.za/documents/generaldocument/LED_Guidelines_March_2005.pdf

Qëllimi i Zhvillimit ekonomik lokal për ECOLOC është të shpejtojë tranzicionin nga një ekonomi informale e tregut në një ekonomi formale. Kjo arrihet nëpërmjet një analize kuptimplotë, krijimit të një vizioni, planifikimit të kujdesshëm strategjik si dhe mobilizimit të burimeve. ZHEV drejtohet nga qeverisja lokale në partneritet me sektorin privat dhe komunitetin.

**Partneriteti për Zhvillimin e Bashkisë:
Libri ECOLOG Volumi 2**

Ne kutine e mëposhtme pasqyrohen avantazhet e PSZH, ndaj Planifikimit Tradicional të Centralizuar:

Kutia Nr.2

Politikat e zhvillimit tradicional dhe Zhvillimi Ekonomik Lokal/Rajonal

Politikat e zhvillimit tradicional	Zhvillimi Ekonomik Lokal/Rajonal
Qasja nga lart poshte ne te cilen vendimet per nderhyrje te nevojshme ne zona te ndryshme merren nga qendra	Promovimi i zhvillimit te territorit behet me ane te iniciativave te cilat zakonisht vijne nga poshte
Manaxhimi behet nga administrata qendrore	Decentralizmi, kooperimi vertikal ndermjet hallkave te ndryshme te qeverisjes, kooperimi horizontal ndermjet privatit dhe publikut
Qasje sektoriale per zhvillimin	Qasje territoriale per zhvillimin.
Zhvillimi i projekteve te medha industriale per te stimuluar aktivitetin ekonomik	Maksimizimi i potencialit te zhvillimit te çdo zone per te stimuluar regullime progresive te sistemit ekonomik lokal ne kuader te ndryshimeve ekonomike.
Suport financiar, nxites dhe ndihma si faktor kryesor per ta bere sa me terheqes sektorin ekonomik	Sigurimi i kushteve kryesore per zhvillimin e aktivitetit ekonomik

Dhe me tej ne mund te formulojme dhjete dukurite me kryesore qe dallojne politikat tradicionale te hartimit te planit lokal te zhvillimit me ato moderne, ne nje shoqeri demokratike qe ekonomikisht zhvillohet mbi bazen e iniciatives private dhe ekonomise se tregut.

Kutia Nr. 3:

Dhjete Dukurite Politike Praktike ne Hartimin e PSZHSEK

Praktikat tradicionale	Praktikat moderne
1. Subvencionon investimet direkte te huaja, duke injoruar bizneset lokale	Investon ne te gjithë mjedisin lokal te biznesit, duke patur si qellim mbeshtetjen e biznesit dhe te kompanive qe kane potenciale per t'u rritur
2. Nuk ekzistojne modele te ligjshme kombetare apo lokale per Zhvillimin Ekonomik Lokal	Zhvillon kuadrin legjislativ duke mundesuar projekte dhe Plane Strategjike per zhvillimin ekonomik kombetar
3. Fokusohet ne industrine perpunuese dhe nderhyrjet sektoriale	Fokusohet ne sektoret e bujqesise, industrise perpunuese dhe sherbimit, duke mundesuar nje zhvillim te madh
4. Investime ne infrastrukturen e rende	Rritja e vemendjes ne infrastrukturen e lehte, veçanerisht ne burimet njerezore dhe mbeshtetjen e bashkepunimit ndermjet bizneseve
5. Veprime bazuar ne informacionin mbi bizneset e vogla lokale	Te dhena bazuar ne Plane Strategjike.
6. Sektori privat eshte i vetmi aktor real, nuk ka bashkepunim	Bashkepunimi ndermjet aktoreve publike, private dhe komunitetin, udhehiqen nga qeverisja lokale.
7. Drejtohet nga oferta.	Drejtohet nga kerkesa.

8. Nuk vleresohen mekanizmat institucionale per Zhvillimin Ekonomik Lokal, pervec investimeve te huaja direkte	Vihet theksi ne ngritjen e mekanizmave institucionale per te mbeshtetur biznesin e rregullt dhe formal
9. Nderhyrje sektoriale	Nderhyrje territoriale.
10. Zhvillimi Ekonomik Lokal shtrihet brenda kufijve politike	Zhvillimi Ekonomik Lokal shtrihet brenda hapesirave hkonomike dhe ne disa raste nen autoritete te shumefishta

Strategjia e Zhvillimit Lokal, eshte nje nder dokumentet baze mbi te cilen duhet te mbeshtetet zhvillimi i njesise lokale. Ne temel te saj eshte analiza “*Ku ishim*”, “*Ku jemi*”, “*Ku duam te shkojme*”, ose siç quhet ndryshe “analiza e lundrimit”.

Strategjia ka si qellim te saj te evidentojte *vizionin* dhe *qellimet strategjike* per zhvillimin e njesise lokale. Nepermjet tij *orientohen* dhe *konsolidohen* perpjekjet e perbashketa te autoriteteve lokale, te zgjedhura dhe te emeruara, *se bashku me komunitetin*, per nje zhvillim te qendrueshem ne rritje te jetes ekonomiko sociale te njesise per sot dhe per brezat qe do vijne. Ai synon te ndikojte me hapa te programuar dhe me minimumin e rrezikut ne cilesine e jetes ekonomike dhe sociale te komunitetit qe i drejtohet.

Qellimi i zhvillimit ekonomik lokal eshte qe te ndertoje kapacitetet ekonomike lokale per te permiresuar te ardhmen e tij ekonomike si dhe cilesine e jeteses se te gjithve¹

Ne temel te tij dhe nepermjet tij synohet te konsolidohen keto parime te jetes komunitare:

- a) Te krijoje nje shembull real dhe te prekshe te nje procesi strategjik vendim-marres qe perfshin bashkepunimin e gjithë aktoreve lokale, politike, ekonomike, shoqerore e sociale.
- b) T'i siguroje komunitetit dhe qeverisjes lokale nje dokument orientues ne percaktimin e drejttimeve kryesore ne dobi te rritjes se panderprere ekonomike, dokument i cili eshte gjithmone ne proces permiresimi, por jo mohimi, prej te zgjedhurve dhe drejtuesve pasardhes.
- c) Te krijoje ura bashkepunimi dhe te lehtesojte kete bashkepunim midis partnereve publike dhe siper marrjes private per nje zhvillim te koordinuar dhe harmonizuar te njesise lokale.
- d) Te krijoje dhe konsolidoje nje eksperience te re, mbeshtetur tek pervoja e bashkive europiano-perendimore, ne instalimin e nje kulture te planifikimit ekonomik e social.
- e) Te konturoje nje kornize vendimarrrese per çeshtjet dhe detyrimet baze qe ofron njesia lokale ndaj komunitetit nen juridiksionin e saj, te tilla si: sherbimet publike, furnizimin me uje dhe perpunimin e ujrave te perdorura, infrastruktura, klima joshese per biznesin vendas por edhe te huaj etj.

¹ “Local Ekonomik Development”, WB, Bertelsmann Stiftung, Tetor 2004, f1

- f) Te orientoje dhe ndikojne ne politikat e financimit te qeverise qendrore, si dhe te donatoreve, veçanerisht per projekte zhvillimi ne interes te me shume se nje njesie lokale (fqinjët).
- g) Te mundesoje nje qeverisje lokale transparente dhe te besueshme nga komuniteti, efektive dhe qe i pergjigjet me perkushtim dhe profesionalizem nevojave dhe kerkesave me standarte te banoreve dhe vizitoreve te njesise qe administron.

Vlera e strategjise dhe efektiviteti i saj percaktohen nga vleresimi qe i behet hartimit te saj dhe perdorimi ne veprimtarine konkrete, ne te kundert ajo mbetet vetem nje medaljon zbukurues i autoriteteve lokale. Po cilat jane kriteret baze per hartimin e Planit Strategjik te zhvillimit ekonomik?

Ne pasqyren e meposhme jane pasqyruar 10 principet baze qe duhet te udheheqin punen per hartimin e Planit:

Kutia Nr. 4
Dhete Principe Udheheqese per Hartimin e PSZHSEK-se²

Principet Udheheqese te PSZHSEK-se	Shtojce Plotesuese
1. Nje proces strategjikisht i planifikuar	Bazohet ne kushtet lokale ekonomike e sociale, nderton avantazhe konkurruese si dhe sqaron pikat e dobta dhe rreziqet/kercenimet
2. Bazohet ne nje arritje territoriale ³	Menyra me e mire eshte te bazohet ne mundesite ekonomike funksionale ne nivel rajonal ose qyteti, duke perfshire hapesirat rurale dhe urbane
3. Pasuri e hartuar dhe e shpendare lokale	Çdo strategji ka nevojë qe te hartohet dhe shperndahet ne menyre lokale, per t'ju adresuar prioritetet lokale dhe pozicioneve specifike konkurruese
4. Arritjet me te mira nepermjet bashkepunimit si per hartimin dhe zbatimin	Strategji te per zhvillimin Ekonomik Lokal normalisht jane te hartuara nga bashkepunimi i aktoreve publike, privat dhe komuniteti, te udhezuara nga qeverite lokale
5. Perforcim i veprimeve te integruara qeverisese, vertikalisht dhe horizontalisht	Te gjitha nivelet qeverisese jane partnere te nevojsheme ne Zhvillimin Ekonomik Lokal, secili nivel duhet te perforcoje dhe harmonizojë prioritetet lokale me ato kombetare.
6. Fokusohet ne krijimin e nje mjedisi lokal te favorshem ekonomik per te gjithë aktoret	Zhvillimi Ekonomik Lokal mundeson rritjen e sektorit privat, duke perfshire uljen e kostove operacionale, burokracite e panevojshme dhe njohurite asimetrike.
7. Perfshin nderhyrje te harmonizuara	Arritjet tradicionale adresohen ne sektore

² Pershtatur nga Gwen Swinburn www.worldbank.org/ledprimer

³ Fjala eshte per teritoorin nen juridiksionin e komunes ose bashkise

ndermjet sektoreve te shumefishte	te veçante, ndersa Zhvillimi Ekonomik Lokal i drejtohet sektoreve te shumefishte dhe mundeson maksimizimin e sinergjise
8. Perfshin nderhyrje te ekuilibruara ne infrastrukturen e rende, te lehte dhe institucionale	Investimet ne burimet njerezore, infrastrukturen ekonomike, mbeshtetjen institucionale, dhe shtimi i programeve jane perberes te domosdoshem
9. Percaktimi i prioriteteve te zhvillimit dhe ruajtjes se bizneseve dhe banoreve lokale	Arritjet e para te Zhvillimit Ekonomik Lokal, fokusohen ne thithjen e investimeve. Tani fokusi kryesor eshte rritja e bizneseve lokale
10. Projektet u shperndahen te gjithë aktoreve publike, private dhe jo-qeveritare	Çdo sektor ka kompetencat e veta ne shperndarjen e projekteve te Zhvillimit Ekonomik Lokal ne sektoret publike, privat dhe komunitet

Por gjithsesi, e rendesishme eshte qe duke u bazuar ne dhjete principet e mesiperme te dish te analizosh situaten konkrete ne komunen perkatese, ti ballafaqosh ato me problematiken dhe interesat e komunitetit ne teresi apo te biznesit dhe grupeve te tjera shoqerore ne veçanti. Per me teper nje analize e plote ne kete drejtim te jep mundesine qe te percaktosh qarte qellimet, objektivat, programet dhe projektet mbi te cilat do te punosh per nje afat kohor te percaktuar, **por duke patur plotesisht te qarte se ne ç'nivel te zhvillimit ekonomik dhe social do te jemi pas ketij afati kohor.**

Nuk jane te pakta dhe rastet qe edhe pse eshte hartuar nje Plan Strategjik i mire, pas afatit kohor te percaktua, nuk eshte reflektuar zhvillimi i premtuar tek "PLANI", por kjo jo per faj te Planit, por sepse zhvillimi perseri eshte lene "me rrjedhje te lire" dhe i eshte nenshtuar spontanitetit. Ç'do te thote nje praktike e mire dhe jo spontane per nje strategji te sukseseshme? Pergjigja jepet ke kutine nr. 5 ne vijim.

Kutia nr. 5

Nje praktike e mire per nje strategji te sukseseshme

Nje praktike e mire per zhvillimin ekonomik lokal kerkon qasje me kushtet lokale, me poshte paraqiten disa linja udheheqese te sukseseshme: Nje qasje e integruar perfshin çeshjtet sociale, ambjentale, gjeografike dhe gjithashtu ekonomike. Ndertimi i nje strategjie te sukseseshme me te gjithë partneret kryesore bazuar ne vizionin te cilin ata ndajne. Reference per ekonomine informale: ekonomia informale duhet mbajtur nen vemendje me shume kujdes. Ne disa lokalitete ajo mund te perfaqesoje nje pjese te madhe te ekonomise lokale, dhe te jete e lidhur mjaft fort me aktivitetet formale duke siguruar ne kete menyre bazat e ekonomise per pjesen me te varfer. Nje sere projektesh afatshkurter, afatmesem dhe afatgjate per te orientuar partnershipin dhe per te ndertuar konfidencialitetin me mbajtesit e interesit. Drejtues lokale me influence dhe efektive, te cilet perhapin besim, perkushtim dhe aftesi per te bashkuar mbajtesit e interesit. Ndertimin e kapaciteteve per manaxhim si dhe termat baze jane esenciale per implementimin e projektit.

Para se te fillohet nga puna per hartimin e PSZHSEK-se, konceptet e permendura me siper duhet te pervetesohen nga gjithë pjesmaret ne kete proces dhe nje pjese e mire e tyre te delegohen edhe ne komunitet, veçanerisht tek ajo pjese qe do te jete aktive gjate hartimit te planit.

Metodologjia qe po paraqesim i sherben pjeses se pare, pra ndihmon ne punen serioze per hartimin e saj, por kursesi nuk eshte automatikisht vepruese.

Pjesa e I-re:

PUNA PERGATITORE PER HARTIMIN E PLANIT TE ZHVILLIMIT SOCIAL EKONOMIK

I.1. Unifikimi i Emertimit

Nga vrojtimit e bera rezulton se ka diversitet emertimesh te Planit ne komuna te ndryshme te Kosoves, te cilat ose e kane hartuar ate ose jane ne proces e siper, sipas rekomandimeve te donatoreve apo zyrave te konsulences qe jane pajtuar per hartimin e tyre. Çeshtja nuk eshte se emertimi perben thelbin, por gjithesesi, në të duhet te sintetizohet ajo çka eshte marre persiper.

Edhe ne dokumentin *“Sinteza e grupit nder-dikasterial administrate lokale dhe zhvillim lokal”* percaktimi i detyres eshte: *“Programi per metodologjine unike te planifikimit strategjik per zhvillimin ekonomik”* Por ne Rregulloren 2000/45 theksohet *“Komuna eshte bartese kryesore e rrjedhave sociale, (korsivi eshte i yni), politike, ekonomike, kulturore, dhe duhet t’i kordinoje te gjitha keto aktivite”*.

Pra, perpos programimit te zhvillimit ekonomik, ne strategji meritojne nje vemendje po kaq te madhe edhe problemet e programimi i aspekteve sociale. Pare ne kete kendveshtrim, ne do te sugjeronim kete emertim: **“Plani Strategjik i Zhvillimit Social Ekonomik Komunal”** (shkurt PSZHSEK).

I.2. Shtrirja kohore e PSZHSEK-së

Nga pervojat e ndryshme te grumbulluar per hartimin e PSZHSEK-ve, shtrirja kohore e tyre varion nga 10 der ne 15 vjet. Pa dashur te analizojme ne detaje epersite e njerit variant te shtrirjes kohore me tjetrin, ne menyre te permbledhur do te rekomandonim:

- a) Pergjithesisht shtrirja kohore te jete nje vit me teper se PBA kombetare (zakonisht ato jane tre vjeçare) dhe dy vjet me teper se mandati i te zgjedhurve lokale, qe ne Kosove eshet kater vjeçare. E para lidhet me mundesine e punes pregatitore per te siguruar perfshirjen e projekteve lokale te komunes ne burimet financiare te PBA-së kombetare, kurse e dyta lidhet me sigurimin e vazhdimesise nga nje mandat tek tjetri i te zgjedhurve lokale. **Pra, kohezgjatja me optimale e PSZHSEK eshte 10 vjet.**
- b) Kohezgjatja e pergatitjes se PSZHSEK-së eshte zakonisht 16-18 muaj, kurse e rishikimit te saj (pra pasi eshte bere e para) te jete 10-12 muaj.
- c) Mbi kete baze, puna per hartimin e PSZHSEK-se fillon gati nje vit e gjysem para se te hyje ne fuqi PBA-ja kombetare. Kesdhtu sigurohet perputhja kohore e startimit te zbatimit edhe te PBA-se edhe te PSZHSEK-se.

I.3 Synimi

Synimi themelor i Planit strategjik të Komunave në Kosovë do të jetë ai i përcaktuar tek **“Propozimi Gjithpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës”**, nëni 6.2 të të cilit përcakton: *Vetëqeverisja lokale në Kosovë do të bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës dhe efikasitetit e efektivitetit të gjatë, ofrimit të shërbimeve publike, duke kushtuar kujdes të posaçëm nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve jo-shumice dhe pjestareve të tyre”⁴.*

Por hartimi i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomiko-Social Komunal ka edhe këto synime me specifike:

- a) Mbeshtetjen e njesive të qeverisjes lokale të Kosovës në hartimin e strategjive afatmesme e afatgjata të zhvillimit ekonomik-social.
- b) Rritjen dhe aftësimin e kapaciteteve të administratës së qeverisjes lokale për një menaxhim më efektiv të komuniteteve të tyre.
- c) Bashkërendimin e programeve afatmesme e afatgjata të qeverisë qendrore të Kosovës me ato lokale.
- d) Bashkërendimin institucional midis komunave fqinje për thithjen e investimeve dhe programeve me interes më të gjërë se interesi i një komune (si p.sh. fushat e perpunimit të mbetjeve urbane, burimet dhe sistemet e furnizimit me ujë të pijshëm të kontrolluar, kanalizimet e ujërave të përdorura dhe dambat e perpunimit të tyre, segmentet rrugore nderkomunale etj).
- e) Mobilizimin dhe rritjen e efektivitetit të shfrytëzimit të resurseve lokale, në interes të biznesit, rritjes së eksporteve dhe në teresi të rritjes së nivelit ekonomik të komunitetit.
- f) Përfshirjen e komunitetit në vendim-marrje të prioriteteve dhe programeve në shërbim të tyre.

Këto synime behen të mundur të realizohen duke u mbështetur në këto parime orientuese:

- a) Suksesi ekonomik balancohet dhe ndikon në cilësinë e jetës së komunitetit.
- b) Rritja ekonomike bashkëshoqërohet dhe balancohet me kërkesat sociale dhe mjedisore.
- c) Planifikimi strategjik është një proces gjithpërfshirës, i integruar dhe i institucionalizuar në njesinë lokale (komune, bashki)
- d) Bashkëpunimi midis autoriteteve lokale të zgjedhura e të emëruara, biznesit e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit është një element kyç në progresin e qëndrueshëm ekonomik.
- e) Njesia lokale është faktor vendimtar për përmirësimin e vazhdueshëm të klimës për zhvillimin e biznesit vendas e të ardhur në teresi dhe jo e bizneseve të veçante apo të selektuar.
- f) Planit strategjik përcakton drejtësitë dhe elementet kryesore të zhvillimit ekonomik por nuk e dikton dhe kontrollon atë.
- g) Sektori privat është gjeneruesi kryesor i zhvillimit ekonomik dhe i punësimit të njerezve në njesinë lokale.
- h) Në përmirësimin e vazhdueshëm të ekonomisë lokale ka ndikim të drejtpërdrejtë përmirëtimi i institucioneve publike me sipërmarrjen private.

⁴ Propozimi Gjithpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës”, 2 Shkurt 2007, f.5

I.4. Perberja dhe Konstituimi i Komisionit

Serioziteti i pergatitjes te strategjise, fillon qe ne procesin e identifikimit te Komisionit lokal per hartimin e strategjise. Problemi nuk eshte per te gjetur emra qe mbushin kuadratet e skemes se Komisionit. E rendesishme eshte perfshirja e njerezve me perkushtim, **qe realisht e duan qytetin, komunen apo fshatin e tyre dhe jane te interesuar per zhvillimin dhe prosperitetin bashkekohor te tyre.** Procesi i seleksionimit, veçanerisht te anetareve te jashtem, pse jo dhe te stafit te vete komunes, nuk eshte nje proces mekanik.

Hartuesi i Komisionit dhe grupeve te punes, **duhet te jete njohes i mire dhe i trainuar i metodologjise se hartimit te strategjise,** si per te perzgjedhur njezit me te pershtatshem, por edhe per te thithur prej tyre maksimumin e kapaciteteve, pervojave dhe njohurive qe mbartin. Nga ana tjetere ata duhet te jene **“mjeshtra”**, te zgjimit te interesit tek komuniteti, te parashtrimit te ideve tek ata dhe i sigurimit te angazhimit te tyre per qytetin e komunen e tyre dhe te femijeve te tyre. Disa nga kriteret e perzgjedhjes sugjerohet te jene:

- a) Personat me nivel arsimor te cilesuar (me tituj, grada, kualifikime etj), ne territorin e komunes, por edhe me origjine nga komune dhe qe mund te jene me detyra ne komuna te tjera ose organet dhe institucionet qendrore.
- b) Persona qe kane njohuri te plota per historikun e zones (por jo thjesht te historise se zones, komunes por dhe historikun psh te zhvillimit te arsimit, te zhvillimit te kultures, te zejeve te tradites (shih kutia nr.1), ekonomise, bujqesise apo degeve te vecanta te saj (psh prodhimit te veres e deri tek traditat e kulinarise).
- c) Persona qe kane pasur detyra ne qeverisjen lokale dhe aktualisht mund te mos i kryejne ato, por qe mbartin pervoje ne adimistrimin dhe menaxhimin e komunes dhe te komunitetit.
- d) Perfaqesues te spikatur te shoqerise civile ne komunitetin e komunes, por dhe te tille qe jane me origjine nga komuna dhe ushtojne aktivitet jashte komunes dhe ne qender.
- e) Specialiste te fushave te ndryshme, sidomos te tille qe jane me pune jashte komunes (si arkitekthe, informaticiene, mjeke, etj).
- f) Perfaqesuesit me te spikatur te biznesit lokal dhe te institucioneve perfaqesuese te tyre (si oda e tregetise apo biznesit), perfaqesues ose punonjes lokale te bankave te nivelit te dyte (tregtare) qe ushojne aktivitet ne komunen perkatese.
- g) Perfaqesues te shtresave ne nevoje dhe te etnive te ndryshme.
- h) Perfaqesues te institucioneve ose shoqerive publike, me vartesi horizontale ose vertikale (psh furnizimit me energji, uje, telekomunikacion, shendetesi, arsim etj).


Kutia nr. 6
Model Promovimi i Resurseve te Komunes

“Provoni supen e çobanit”

Ne komunen e Keçeçmek-ut ne Hungari, nje komune me rreth 13 mije banore, qe shtrihej ne zonen fushore dhe qe si drejtim kryesor kishte prodhimin e vererave te bardha tip “Tokai”, gatimi me tradicional ishte e ashtuquajtura “supa e çobanit” qe presupozonte, supe me mish lope, patate dhe erza mali, te gatuar ne ene prej balte mbi zjarr natyral. Para hartimit te strategjise se zhvillimit kjo komune nuk njihej per zhvillimin e turizmit. I vetmi resurs natyror ishte nje pyll i vjeter komunal, me nje siperfaqe te konsiderueshme, dhe qe mirembahej me rregulla shume te forta nga atoritetet lokale dhe komuniteti dhe qe veç te tjerash, mbartete dhe vlera klimaterike. Por gjithesei, nuk mund te joshite turistet as me veren (verera te mira e speciale me se shumti gjen ne vende te tjera europiane) dhe as me vlerat klimaterike te pyllit. E veçanta joshese u gjet tek supa e çobanit. Tek flete palosja promovuese dhe per gjate gjithë rruges, per ne komune shkruhej “ketu do te provoni supen me te shijshme te jetes suaj” ose “Pasi ta provoni njehere ju do te riketheni per te shijuar supen me te shijshme te jetes suaj” Autoritetet lokale pohonin se si rezultat i *supes*, frekuentimi turistik rritej me 3-5 here nga viti ne vit.

Si strukture te pershtateshme, per komisionin e hartimit te planit strategjik do te rekomandonim:

Skema Nr. 2
Komisioni i Hartimit te Planit Strategjik te Zhvillimit Social Ekonomik Komunal



Antare te perhershem te Komisionit rekomandohet te jene:

1. Drejtori i Departamentit te Koordinim Zhvillimit ne Komune, njeherazi dhe n/kryetar i Komisionit.
2. Dy antare te Keshillit Komunar, rekomandohet Kryetari i Komisionit Buxhet-Finances dhe i Komisionit per Punet Publike.
3. Te kater kryetaret e grupeve te punes
4. Dy personalitetet me te spikatur te qytetit (rekomandohet kryetari i OBK-se).

Mbledhja e Komisionit, drejtohet gjithmone nga Kryetari i Komunes qe eshte njeherazi dhe Kryetar i Komisionit. Ne bote njihen edhe pervoja qe caktohet si n/kryetar i Komisionit, zv/kryetari i Bashkise/Komunes, por pergjithesisht praktika tregon se ne keto raste, Kryetari i Komunes i delegon gjithe ngarkesen dhe vete mbetet "jashte loje", ne nje ndermarje te rendesishme per zhvillimin e komunes.

Grupet e punes perbehen zakonisht nga 15-20 antare, prej te cileve njeri eshte nga administrata e komunes, qe organizon dhe mbeshtet gjithe veprimtarine e grupit, kurse te tjeret jane nga perfaqesuesit perkates te grupeve qe jane perzgjedhur.

Kryetaret e grupeve te punes i perzgjedh dhe ja propozon per miratim Kryetarit te Komunes, Departamenti i Koordinim-Zhvillimit ne Komune. Anetaret e grupeve, sipas kritereve te siperctuara zgjidhen nga Kryetari i Komunes, Kryetari i grupit perkates dhe Drejtori i Departamentit te Koordinim-Zhvillimit.

Lista e plote e anetareve te Komisionit dhe anetareve te grupeve eshte pjese e Planit dhe gjithmone i bashkengjitet atij.

Me poshte po paraqesim ne menyre te permbledhur, grupet e interesit, potencialisht te mundeshem per t'u aktivizuar gjate procesit te hartimit te planit strategjik.

Kutia nr. 7

Perfaqesues te grupeve te interesit potencialisht pjesmarres ne hartimin e Planit Strategjik

Sektori Publik	Sektori Privat	Perfaqesue te Komunitetit
a) Departamentet teknike ne Komune	a) Korporata te medha(VIP)	a) Drejtues te komunitetit
b) Perfaqesues te qeverisjes rajonale (qarkut)	b) Bashkimet sindikale	b) Organizata qe perfaqesojne sherbime komunitare.
c) Perfaqesuesit e ndermarjeve publike komunitare ose rajonale (Shendetesi, arsim, telekomunikacion etj)	c) Ndermarjet e vogla e te mesme, agjensite imobilare lokale	c) Institutet e edukimit lokal ose rajonal
d) Perfaqesues te bordeve menaxheriale rajonale (psh bordi i ujit, burimeve minerare etj)	d) Bankat dhe grupet e tjera financiare	d) Sektori fetar lokal ose rajonal
e) Perfaqesues te instituteve studimore dhe akademike.	e) Dhomat e tregetise	e) OJF si dhe perfaqesues te grupeve sociale te ndryshme: minoriteteve, te paafteve, shtresave me probleme sociale dhe te diskriminuara, te mbrojtjes se mjedisit, kulturore, arteve dhe historike
f) Perfaqesues te sherbimeve komunale	f) Media	
	g) Grupet e tjera qe mbeshtetin biznesin	
	h) Shoqata profesionale	
	i) Sherbimet komunale private	
	j) Qendra arsimore priva	
	k) Think thanks	

Per te siguruar mbarvajtjen dhe funksionimin e grupeve te punes, zakonisht caktohen dhe “pikat e kontaktit”. Pregatitja e punes dhe ndjekja e problemeve te grupeve te punes eshte nga me thelbesoret dhe me ngarkese si per vete grupin dhe per departamentin, prandaj ne se lejojne mundesite finaciare te komunes, ose ne se eshte siguruar ndonje donacion per realizimin e planit, mire eshte qe si “pika kontakti” te pajtohen dy nepunes te rinj “full-time”, per aq kohe sa do te vazhdoje pergatitja e Planit Strategjik.

Eshte i rendesishem fakti qe struktura dhe perberja e Komisionit te kaloje per miratim ne Keshillin Komunal. Kjo jo vetem qe rrit pergjegjesine e vet Komisionit, por njeherazi edhe te vendimarrjes. Pergjithesisht puna e anetareve te Komisionit (sidomos e atyre jashte administrates komunale) eshte angazhim vullnetar, por me sukses jane aplikuar dhe miratuar ne “Buxhetin e hartimit te Strategjise” edhe shperblime (shih bashkengjitur “Parashikimi i shpenzimeve per hartimin e strategjise”).

Nderkohe nuk duhet neglizhuar edhe momenti i konstituimit te ketij komisioni, mbledhja e te cilit duhet te jete tejet e pergatitur.

Ne do te rekomandonim kete rend dite te mbledhjes se pare te konstituimit te Komisionit per hartimin e planit strategjik:

- I. Fjala e hapjes e Kryetarit te Komunes
- II. Miratimi i rregullores se punes se Komisionit
- III. Miratimi i kalendarit te veprimtarive te Komisionit.

Nderkohe administrata lokale ka pergatitur nje dosje pune per gjithë antaret e Komisionit e cila permban, veç rregullores dhe kalendarit te veprimtarive edhe;

1. Metodologjine e hartimit te planit te zhvillimit ekonomiko-social te komunes,
2. Ne se komuna ka patur ne periudha te kaluara plan strategjik,
3. Plani i prioriteteve te komunes per vitin ne vazhdim,
4. Te dhena mbi buxhetin e komunes dhe shperndarjen e fondeve per vitin ne vazhdim.
5. Te dhena te tjera njohese e prezantuese qe mund te kete te pergatitura komuna.

Kryetari i Komunes, qe eshte njeherazi dhe kryetar i Komisionit te hartimit te strategjise, ne fjalen e tij mban parasysh edhe keto momente:

- a. Vendi dhe roli i punes qe ka marre persiper komisioni dhe ndikimi i tij ne menaxhimin dhe zhvillimin e komunes,
- b. Baza ligjore mbi te cilen do te mbeshtetet hartimi i Strategjise se Zhvillimit Ekonomik Lokal,
- c. Detyrat kryesore te Komisionit dhe te anetareve te tij.

Kujtese!

Mbledhja e konstituimit eshte mbledhje e hapur per publikun dhe ne te sigurohet pjesmarja e mediave lokale.

Sikurse shihet ne skemen kryesore te organizimit te Komisionit te hartimit te PSZHSEK-se, dy degezimet kryesore jane Agjensia Rajonale e Zhvillimit dhe Departamenti i Koordinim Zhvillimit ne Komune.

Ç'fare eshte dhe pse merr nje rol te veçante ARZH-ja, gjate procesit te zbatimit te PSZHSEK-së? ARZH-te operojne ne nivel rajonal dhe kane mandate ekonomiko-social. Objektivi i tyre kryesor eshte krijimi i kushteve per burim te ardhurash

dhe promovimi i punesimit. ARRZH-te sigurojne forume per te inkurajuar dialogun ndermjet pefaqesuesve te shoqerise civile, sektorit privat dhe qeverisjes lokale. Ato operojne si nje rrjet (network) me filiale ne te gjithë territorin. Kjo ben te mundur shkembimin e informacionit mbi nevojat, prioritet dhe mundesite ekonomike.

Duke perdorur qellimin dhe fuqine e çdo organizate ne kontekstin local, institucional dhe social, ARZH-te rrisin mundesite per negociata ndermjet gjithë anetareve. Ato bejne gjithashtu te mundur te ndajne manaxhimin e kostove per implementimin e iniciativave dhe projekteve. Stafi i ARRZH-ve perbehet nga ekspert lokale te trajnuar ne fusha te ndryshme si manaxhim, metodologji mbi pjesemarrjen, pefaqesimin, plan zhvillimi, vleresim projektesh, mikro kredite etj. ARZH-te u sigurojne sherbim bizneseve, organizatave me baze komunitare dhe qeverisjes lokale.

Natyra e sherbimeve te ARZH-se varet nga karakteristikat e klientit si dhe nga kerkesat e buxhetit. Zakonisht nepermjet ARZH-ve trajtohen tre lloje klientesh:

- a) sipermarresit e sektorit privat, te cilet marrin asistence teknike dhe i ndihmohen ne identifikimin e mundesive;
- b) komunitetet, te cilet perfitojne asistence teknike dhe forcimin e kapaciteteve organizative, dhe
- c) qeverite lokale, te cilat mund te asistohen me plane strategjike, ngritje fondesh etj., ne procesin e zhvillimit te ekonomise lokale ne pergjithesi.

Nder sherbimet kryesore qe mund te ofroje ARZH-ja, ne interes te qeverisjes lokale jane:

- **Sherbimet komunitare:** zakonisht ofrohen nga aksione te vegjel, te cilet synojne mikro-aktivitete te cilat ofrojne asistenece teknike ne manaxhim, finance dhe identifikimin e bizneseve, qellimi eshte permiresimi i organizimit te komunitetit dhe pjesemarrjes. Keto jane projekte qe synojne ngritjen e kapaciteteve te nevojshme per transformimin e komunitetin lokal ne aktore te vertet zhvillimi, te afte per te menaxhuar iniciativen e ARZH-se.
- **Sherbime promocionale:** keto jane projekte mesatare (me buxhet nga 10,000 deri ne 30,000 Euro) te fokusuara ne organizata, shoqata, dhe mbajtesit e interesit private, ku sherbimi mund te perfshije vleresimin e tregut, analizen e kostove dhe te perfitimeve, vleresime mbi fitimin nga investimet, duke shtuar edhe asistence teknike ne formulimin e projekteve. Keto projekte tregojne aktivitetin real te ARZH-ve dhe kane nje ndikim te shpejte mbi perfituesit dhe vendin.
- **Sherbime Strategjike:** keto kane nje ndikim shume te madh ne lidhjen e skemave produktive (prodhim/komercializim) si dhe ne nivel lokal, duke siguruar mbeshtetje per grupet vulnerabel. Ato jane afatmesme dhe afagjate dhe kerkojne me shume burime sesa ARZH-te mund te ofrojne, pranadaj roli i tyre eshte i kufizuar ne identifikimin e projektit.

Qendrueshmeria e ARZH-se varet nga disa faktore, nder te cilet mund te permendim:


1) **Vleresimi politik dhe social:** ARZH-te jane te njohura si organizata pefaqesuese te cilat operojne ne interes te komunave edhe/ose rajoneve dhe jane te besueshme nga komunitetet e tyre.

2) **Kapacitetet teknike:** Ato kane ekspertizen e nevojshme per te siguruar sherbime te orientuara nga kerkesa dhe per nje game te gjere klientesh nga sektori publik tek ai privat.

3) Autonomi financiare: ARZH-te nuk jane donatore te varur, as donator te drejtuar. Ato mund te gjenerojne te ardhura te bazuara ne: taksa, sherbime per klientet, menaxhimin e fondeve te kredive, te kontraktotjne kushtet me organizata nderkombetare ose struktura qeveritare, kuotizacione nga anetaresia, nga ndermarrjet e perbashketa (joint ventures) dhe nga partneritete eficiente. Pergjithesisht, sipas statusit te saj ligjor, ARZH-ja, mbetet ne formen e nje organizate jo-fitimpruresse e cila investon “fitimin” (surplusin) e saj ne projekte per zhvillim.

Por, gjithsesi problemi me i madh i Komisionit te Hartimit te PSZHSEK-se eshte terheqja e mendimit te komunitetit. Pa siguruar pjesmarjen e komunitetit ne hatimin e PSZHSEK-se eshte i kompromentuar edhe zbatimi i tij.

Ashtu si ne gjithe vendet e lindjes edhe ne Kosove vihet re nje renie theksuar e interesit te komunitetit per te diskutuar mbi problemet qe preokupojne jeten e tyre. Kjo sepse nen regjimet e kaluara per shume arsye, ky “interes” ishte i imponuar nga vete sistemi ose/edhe shume probleme te perbashketa “zgjidheshin” prej tij. Tashme te lodhur prej tij, e kane braktisur kete lloj kumtimi. Te dhenat e nxjerra nga “Mozaiku i Kosoves 2006”, flasin per kete pergjegjesi dhe veshtiresi. Pyetjes: *A keni degjuar per ndonje takim publik te organizuar nga komuna juaj gjate 12 muajve te fundit?* i jane pergjigjur;



Interesant eshte fakti, se per te tilla takime te organizuara nga komuna, vetem 13% e te intervistuarve, deshmojne se njoftimin e kane marre nga komuna, 41% nga TV, dhe pjesa tjeter nga burime te tjera informimi. Eshte e rendesishem qe 42% (qe per ne eshte pjesa e sinqerte e pergjigjeve) nuk vijne ne te tilla takime sepse: **mungesa e interesimit per temat, takimet nuk jane informative, ose/dhe nuk jane produktive.** Kurse 53%, nuk kane patur kohe (pergjigje me pak e besueshme)

Mbi kete baze eshte e rendesishme qe:

- Takimet me komunitetin te jene shume te pergatitura
- Ato duhet te jene te adresuara mire (nuk mund te kerkosh mendime si te zgjidhim çeshtjen e strehimit kur pjesmaresit nga komuniteti ne takim e kane 100% te zgjidhur ose ne zgjidhje e siper problemin)
- Te perdoren metoda video per te prezantuar si e kane bere dhe ku kane arritur te tjeret.
- Te mos zgjasin me shume se dy ore.

- e) Njoftimi ne media te mos jete i thate (date X, ora Y, vendi Z, ftoheni te merrni pjese). Nepermjet lajmerimit te zgjohet interesi dhe kurioziteti.
- f) Te mos kete me shume se dy lektore (dhe keta te alternuar), ne menyre qe te terhiqen ne diskutim sa me shume te pranishem nga komuniteti.

I.5. Ndryshimet ne Struktura dhe Organigramen e Administrates Komunale

Para hartimit te PSZHSEK-se, eshte e nevojshme te rishikohet organigrama e funksionimit dhe e detyrave te administrates komunale, si ne funksion te hartimit ashtu edhe te zbatimit te PSZHSEK-se.

Nga vrojtimit e deri tashme rezulton se ne jo pak raste ato hartohen dhe zbatimi i tyre eshte kryesisht detyre e departamentit te ekonomi-finances prane komunes, ose jo ne te gjitha ndermarjet eshte siguruar qe ne krye te Komisionit te jete Kryetari i Komunes. Megjithate ja disa komente dhe alternativa⁵:

Kutia nr.8

Ku do te vendoset njesia per administrimin e procesit te hartimit te PSZHSEK-së?

Tre mundesite me te njohura se ku mund vendoset njesia per administrimin e procesit te hartimit te PSZHSEK-së jepen ne vijim. Autoritet lokale perzgjedhin modelin me te pershtatshem ne gjykimin e tyre, pas nje analize te plote te faktoreve dhe rrethanave specifike te komunes se tyre.

Tek Shefi i Kabinetit ose Zyra e Kryetarit te Komunes.

Ky obsion ka avantazhet e vet te transparences, si dhe gjithe stafin kryesor (senior) i cili e mbeshtet ate. Duke u vendosur ne kete departament PSZHSEK-ja ka nje profil me te larte si dhe vendos me teper ne fokus politikat dhe lehtesite qe ai sjell, gje e cila mund te garantoje koordinimin edhe me departamente te tjera te komunes/bashkise. Megjithate mund te kete me pak burime per zbatimin e strategjise dhe te sjelle nje varesi nga bindjet politike te kryetarit te bashkise. .

Ngritja e nje Departamenti Funkcional.

Nje departament funksional perfaqeson nje njesi perberese te drejtimit te komunes, psh siç mund te jete Zyra e Planifikimi Urban. Ne kete obsion, PSZHSEK-ja mund te suportoje disiplinen kryesore te departamentit. Psh. nqs vendoset tek Departamenti i Planifikimit Urban, planifikimi strategjik i zhvillimit ekonomik lokal mund te influencohet dhe te drejtohet kundrejt çështjeve te pronesise dhe te infrastruktures dhe influenca e tij mund te limitohet ne çështje te tjera te rendesishme siç eshte permiresimi i klimes per funksionimin e biznesit (psh krijimi i fasiliteve per regjistrimin dhe operimin) si dhe aspekte te tjera te lidhura (psh promovimi kooperativave dhe zhvillimit te Ndermarjeve te mesme dhe te vogla). Nje menaxhim i mire dhe zhvillimi i qasjeve multitidisiplinare do te ndihmojne per te siguruar hartimin e nje politike te mire si dhe nje zbatim te suksesshem te strategjise per zhvillimin ekonomik lokal/rajonale.

Qasja e Agjencise Rajonale te Zhvillimit.

⁵ Shkeputur nga "Local Ekonomik Development", WB, Bertelsmann Stiftung, Tetor 2004, f.43

ARZH-te kane potencial per te permiresuar kordinimin si dhe per te krijuar sinergji me organizata te ndryshme qeveritare ose jo. Nje ARZH mund te siguroje nje kuader organizativ me te qendrueshem. Kujdes duhet treguar me ARZH te cilat jane te pavaruara ose gjysem te varura, per te siguruar nje perfaqesim edhe te atyre mbajtes te interesave te cilet kane nje profil politik ose ekonomik te ulet. (psh shtresat ne nevoje ose grupet shoqerore vulnerabel, te varferit) si dhe t'u sigurohet nje akses i mjaftueshem ne perdorimin e burimeve dhe ne marrjen e vendimeve. Mbledhjet publike, bordet e aksionereve, si konsultime qytetare jane mjete per te siguruar nje pjesemarrje te gjere.

Megjithate duke vleresuar kushtet aktuale te administrates lokale te Kosoves, do te rekomandonim qe, atje ku nuk eshte percaktuar ende, ne organigramen e administrates publike duhet te futet njesia (departament, drejtori, ose zyre) e Koordinim-Zhvillimit. Pikerisht kjo zyre dhe punonjesit e saj do te menaxhojne, organizojne dhe koordinojne gjithë punen dhe aktivitetet ne kuadrin e pregatitjes se planit strategjik. Por detyrat e kesaj zyre nuk kane te bejne thjesht dhe vetem me planin e zhvillimit (Shih kutia nr. 9).

Kutia nr. 9

Detyrat kryesore te Departamentit te KoordinimZhvillimit ne Bashkine (Karlshtad-Suedi)

1. Departamenti i koordinim Zhvillimit pergjigjet para Kryetarit te Bashkise dhe Keshillit Bashkiak per koordinimin e gjithë veprimtarive planizuese qe ndermerr bashkia duke siguruar pjesmarrjen e nevojshme ne to administratat bashkiake dhe aktoreve te tjere brenda dhe jashte juridiksionit te bashkise
2. Çdo fillim viti paraqet per miratim tek Kryetari i Bashkise programin e projekteve dhe te inisiativave zhvilluese qe do te ndermarre bashkia.
3. Ne bashkepunim me departamentin e urbanistikës koodrinon veprimtarine e aktorve dhe faktoreve jashte bashkie ne mbeshtetje te hartimit te planeve te reja te zhvillimit te qytetit.
4. Ne bashkepunim me departamentet e tjera ndjek dhe koordinon matricen e akteve qe parashikon te paraqiten ne Keshillin bashkiak.
5. Ne bashkepunim me departamentin e urbanistikës dhe ate te puneve komunale ndjek dhe kordinon aktoret dhe faktoret e jashtem per realizimin e programit GIS
6. Ne bashkepunim me departamentin e mardhenieve me jashte ndjek dhe koordinon veprimtarine e donatoreve dhe donacioneve per te tretet qe i ofrohen dhe ofron bashkia.
7. Ne bashkepunim me departamentin e mardhenieve me jashte shqyrton, pregatit dhe parqet per miratim gjithë dokumentacionin e binjakezimeve me bashki te ndryshme brenda dhe jashte vendit.
8. Mban lidhje te rregullta dhe koordinon veprimtarine e bashkise me organizatat jofitim pruresë qe veprojne ne teritorin e bashkise dhe jashte saj.
9. Ne bashkepunim me zyren e promocionit dhe te turizmit koordinon dhe pergatit materialet promovuese dhe guidat turistike te qytetit te Karlshtadit.
10. Ne bashkepunim me Zyren e Kryetarit te Bashkise dhe departamentin e mardhenieve me jashte pergatit pritjen e gjithë delegacioneve qe vijne per vizite ne godinen e Bashkise se qytetit si dhe drejton protokollin dhe ceremonialin e ketyre pritjeve

11. Ne bashkepunim me departamentin e mardhenieve me jashte pregatit gjithë procedurat e vizitave te punes se Kryetarit te Bashkise dhe pjese e delegacioneve perfaqesuese te Zyres se Kryetarit te Bashkise.
12. Detyrat specifike te zyrave dhe punonjesve:(Ketu vendosen detyrat me specifike, sipas komunes perkatese, ose dhe detyra shtase, per nje periudhe nje-dy vjeçare, deri ne rishikimin dhe kompletimin e struktures administrative te komunes)

PSZHSEK-ja, duke qene dokumenti baze dhe me i rendesishem i komunes, jo vetem ne hartim por edhe ne zbatim, do te rekomandonim qe qysh ne hapat e pare duke u mbeshtetur tek metodologjia e hartimit te planit strategjik, te sigurohej nje perputhje midis struktures e organigrames se administrates komunale me planin, veprimtarite dhe detyrat per zbatimin e tij nga administrata komunale. Ky rishkim eshte i domosdoshem sepse gjate procesit te zbatimit te PSZHSEK-se, komuna ripozicionon edhe kendveshtrimin e punes dhe te veprimtarise se vet:

Komuna duhet ta shikojë veprimtarine e saj jo vetem si subjekt i biznesit (pra mbeshtetes i tij), por edhe si objekt te tij (pra vete komuna eshte nje shoqeri me veprimtari tregetare).

Mbi kete koncept, gjithë departamentet teknike, por edhe ato financiare e sociale ne komune e riorganizojne punen e vet ne mbeshtetje te biznesit, duke e konsideruar veprimtarine e tyre si partnere te biznesit lokal, por edhe si nje subjekt qe kryen vete veprimtari biznesi.

I.6. Te dhena te Pergjitheshme te Komunes

I.6.1 Historiku

PSZHSEK-ja ka nevojë, por nuk merr persiper te beje historikun e Komunes, apo te fshatrave qe perbejne ate. Prezantimi i shkurter i historise se komunes, ka per qellim te tregoje qe ne jetojme dhe zhvillohemi jo ne nje "toke te shkrete" dhe as jemi ne ata qe do te permbyllim kete mision.

Ne historikun e komunes permenden vetem ngjarje dhe data te konfirmuara dhe te pranuar nga te gjithë si te verteta historike. Mund te kete dhe ngjarje apo data qe jane te rendesishme por qe jane te diskutueshme dhe per te cilat nuk ka nje qendrim nga grupet shoqerore ne komune. Veçanerisht mire eshte te perjashtohen ato ngjarje historike te diskutueshme qe mund te behen burim konflikti midis fshatrave e qyteteve perberese te komunes, ose dhe me gjere, grupeve te ndryshme etnike dhe atyre fetare, etj. Psh nuk ka pse te trajtohet kur erdhen, kush i solli dhe pse i sollen romet apo jevgjitet e pare ne trojet e komunes sone. Kjo pike mund te kete rendesi, por jo nga pikepamja e PSZHSEK-se, sepse ne plan ne do te mundohemi te hapim horizont per te gjithë grupet shoqerore dhe do te prezantojme ne te politika integrimi dhe bashkepunimi per te gjithë pjestaret e komunitetit tone. Mbi kete baze ne do te orientonim qe ne historik te futeshin:

- a) Cilet jane te paret tane, dhe çfare deshmish te jetes se tyre kane mbriritur deri ne ditet tona dhe qe perbejne objekt te vizitoreve turistike.

- b) Cilat jane deshmite kryesore te luftes se popullit te komunes krahines per mbijetese dhe mosasimilim.
- c) Cili eshte kontributi i zones ne luften kunder nazi-fashizmit, ne luften e vitit 1999, etj..
- d) Cilat jane datat dhe ngjarjet e zhvilluara ne zonen e komunes sone, por qe per nga vendimet kane patur vlera kombetare.
- e) Cilat jane figurat me te spikatura nga komuna jone te luftes per mbijetese kombetare, kulturore, gjuhesore etj.

1.6.2 Shtrirja gjeografike

Duke u ndalur ne keto referime te domosdoshme:

- a) Jepen koordinatat gjeografike, lartesia mbi nivelin e detit, tip kryesor i zones (fushore, rrafshnalte, kodrinore, malore apo pjese te tyre).
- b) Prejardhja dhe karakteristikar gjeologjike te zones ku shtrihet komuna.
- c) Lumenjte qe burojne ose kalojne neper komunen tone, liqenet (edhe ata te vegjel alpine), mallet dhe majat me te larta te zones, ose ne se jane te dallueshme edhe nese nuk ndodhen ne teritorin e komunes por afer saj.
- d) Te dhenat kryesore per sasine e reshjeve dhe regjimin e temperaturave.

1.6.3 Popullsia

Duke u ndalur dhe pasqyruar keto te dhena te domosdoshme:

- a) Numri banoreve ne 10 vjetet e fundi dhe grafiku i rritmeve te rritjes (ose te renies se popullsise) Ne se ka renie te rritmeve te rritjes permenden dy ose tre faktoret me percaktues te ketij fenomeni demografik. Perberja meshkuj femra.
- b) Vendi i popullsise se qendres se komunes, ndaj popullsise se gjithë komunes dhe numri i banoreve te gjithë komunes ne rajon apo ne nivel Republike.
- c) Perberja e popullsise se komunes sipas etnive (pa perjashtuar asnje grup) dhe per ndonje grup mund te jepet edhe trendi i rritjes ose zvogelimit, por jo me pak se ne nje periudhe 10 vjecare. Perberja e popullsise sipas besimit fetar.
- d) Numuri i lindjeve dhe i vdekjeve per 1000 banore, mortaliteti infatil per 1000 lindje, trendi. Saldoja migruese, trendi, 2-3 shkaqe. Raporti i lindjeve meshkuj/femra.
- e) Struktura e popullsise sipas grupmoshave per vitin me te fundit (<1, 1-4 vjeç, 5-9, 10-14 vjeç, 15-19, 20-34, 35-54 vjeç, 55-64, >64 vjeç) Mosha mesatare e popullsise, koeficienti i plakjes.

1.6.4 Infrastruktura

Duke pasqyruar permbledhtas keto te dhena:

- a) Gjatesia ne kilometra e rrugeve te asfaltuara qe pershkojne komunen, prej tyre sa rruge nacionale. Raporti Km rruge/Km2 siperfaqe.
- b) Gjatesia e rrugeve te pasfaltuara (mundesisht edhe sipas llojit, me zhavor, dheu, guri etj). Raporti km rruge/Km2siperfaqe.
- c) Gjatesia e rruges hekurudhore qre pershkon komunen dhe pikat fundore te saj.
- d) Furnizmi me Energji Elektrike (i mire, i mjaftueshem, i dobet)
- e) Shtrirja e telekomunikacionit (i mire, i mjaftueshem, i dobet), Nr.telefonave fiks/000 banore.

1.6.5 Sherbimet Publike

Duke u ndalur dhe pasqyruar keto te dhena te domosdoshme:

- a) Gjendja e sistemit te furnizimit me uje te kontolluar (i mire, i mjaftueshem, i dobet). Sasia e ujit l/fryme/24 ore.
- b) Gjendja e sistemit te kanalizimeve te ujrave te perdorura (i mire, i mjaftueshem, i dobet) Sistemet e depozitimit (damba kolektive te kontrolluara, damba individuale (familjare) te kontrolluara me derdhje ne lume, prrua.
- c) Sistemet e menaxhimit te pastrimit dhe grumbullimit e trajtimit te mbetjeve urbane te ngurta (i mire, i mjaftueshem, i dobet)
- d) Menaxhimi i gjelberimit, sherbimit urban dhe sherbimi i funeralit ne komune.

1.6.6 Arsimi

Duke pasqyruar permbledhtas keto te dhena:

- a) Shtrirja e arsimit fillor dhe numuri i nxenesve
- b) Shtrirja e arsimit post fillor, para te mesem dhe numuri i nxenesve
- c) Shtrirja e arsimit te mesem dhe numuri i nxenesve
- d) Numuri i studenteve ne komune dhe trendi i 10 vjeteve te fundit.
- e) Numuri i analfabeteve, trendi dhe vendi i tyre ne popullsine e komunes.
- f) Numuri i arsimtareve dhe pedagogeve. Vendi i tyre per 1000 nxenes dhe per 1000 banore.

1.6.7 Punesimi

Duke u ndalur dhe pasqyruar keto te dhena te domosdoshme:

- a) Vendi i te punesuarve ne raport me popullsine. Punesimi sipas gjinise. Struktura e te punesuarve: sektori publik, te vetpunesuar, te punesuar ne sektorin privat (pa te vetpunesuarit).
- b) Vendi i te papunesuarve ne raport me popullsine dhe te punesuarit. Struktura e te papuneve sipas grupmoshave dhe arsimimit.
- c) Struktura e te punesuarve sipas degeve kryesore: ne bujqesi, ne agrobiznes, ne dege te tjera me karakter industrial, ne sherbime, ne tregeti.

- d) Struktura e te punesuarve ne sektorin publik: ne administrate, ne shendetesi, ne arsim etj.
- e) Vendi i te punesuarve jashte vendit.

1.6.8 Profili ekonomik i Komunes

Duke u ndalur dhe pasqyruar keto te dhena te domosdoshme:

- a) Permbledhje e karakteristikave kryesore te zhvillimit ekonomik per periudhen 1979-1999.
- b) Permbledhje e tendencave kryesore te zhvillimit ekonomik pas vitit 1999
- c) Drejtimet kryesore te zhvillimit ekonomik :
 1. Dege me karakter industrial (posaçerisht vendi ne te i fasonit-prodhimet me material porositesi)
 2. Zhvillimi i bujqesise. Struktura e administrimit te tokes. Sistemet e kanalizimeve dhe ujitjes se tokes.
 3. Siperfaqet e kulturave kryesore. Trende ndryshimi. Prirje.
 4. Perpunimi i produkteve bujqesore.
- d) Zhvillimi i turizmit. Pervoja. Prirjet
- e) Zhvillimi i sektorit privat dhe komunitetit te biznesit. Shkalla e organizimit ne shoqata. Mardheniet me qeverisjen lokale.
- f) Struktura e ndermarrjeve dhe prodhimit. Sektori publik. Sektori privat.

1.6.9 Qeverisja

Duke pasqyruar permbledhtas keto te dhena:

- a) Struktura dhe organigrama e administrates komunale.
- b) Struktura dhe perberja e komisioneve te Keshillit Komunal.
- c) Te ardhurat dhe shpenzimet komunale per dy vjet e fundit, para hartimit te PSZHSEK-se,
- d) Tregues te tjere te menaxhimit ne Komune (projekte dhe bashkepunime me donatore qe jane ne proces)

1.6.10 Organizatat jo-fitimpruresse lokale dhe nderkombetare.

Listo organizatave jo fitimpruresse rezidente ne komune, vendase dhe te huaja, aktivite dhe projekte te perbashketa qe jane realizuar ose jane ne proces deri ne momentin e fillimit te punes per hartimin e PSZHSEK-se.

PJESA E DYTE:

DOKUMENTACIONI PERBERES I PLANIT STRATEGJIK

Pergjithesisht nje Plan Strategjik i Zhvillimit social ekonomik duhet te permbaje keto dokumenta kryesore:

1. Vizioni dhe Qellimet
1. SWOT, Analiza e Konsoliduar
2. Matrica e Qellimeve te Planit, Objektivave, Programeve dhe Projekteve.
3. Matrica e Zbatimit te Planit,
4. Matrica e Prioritarizimit te Projekteve,
5. Projekt-fishat

II.1 Vizioni dhe Qellimet

Percaktimi i vizionit per zhvillimin ekonomiko-social te komunes eshte qe t'i mundesoje komunitetit te artikuloje se ku deshiron ai te jete ne te ardhen, si e perfytyron ai kete zhvillim dhe çfare rruges mund te ndiqen per te shkuar tek ai zhvillim. Vizioni do t'ju jape qytetareve, por dhe vete qeverisjes lokale nje ide te plote se çfare duhet bere dhe ku duhen perqendruar burimet dhe energji e tyre.

Pergjithesisht vizioni konceptohet dhe zhvillohet nga Komisioni i hartimit te Planit Strategjik pas konsultimit me segmente te ndryshem te komunitetit dhe grupeve te interesit. Ne se eshte e mundur, projekt-koncepte te tij diskutohen ne studio mediatike televizive per te zgjuar interesin e publikut por dhe per te zhvilluar tek ata konceptin e vizionit. Ne mungese te tyre do te rekomandonim nje forum qytetar me nje skenar te parapregatitur, i cili mbart ne vetvete si anen zberthyes te vizionit dhe terheqjen e mendimit per konceptualitetin e tij. Mund te shkohet deri aty sa te pranishmeve ne forum ju kerkohet te votohet per tre projekt-konceptet e parapergatitura dhe ndonje qe mund te formulohet nga diskutimet ne salle.

Ne themel vizioni konceptohet *si ideal i cili i ka rrenjet ne aspektin human, natyror, gjeografik, ekonomik, social, historik e kulturor te komunes*. Ai synon te permbushe pritshmerine dhe aspiratat e komunitetit dhe te percaktoje nje drejtim te qarte te zhvillimit ekonomiko-social te komunes.

Nga percaktimi i sakte fillestar varet dhe jetegjatesia e vizionit. Por gjithsesi gjate proceseve te rishikimit ose rihartimit te dokumentit te strategjise per periudha te reja kohore, ai rishikohet dhe plotesohet ne menyre te natyrshme, pa kembengulur se eshte i paprekshem.

Ndersa percaktimi i *qellimeve*, ndihmon ne vendim-marrjen lidhur me rruget dhe menytrat per te arritur ndryshimet qe nevojiten. Ne funksion dhe mbeshtetje te vizionit caktohen pese-gjashte qellime (natyrisht mund te caktohen dhe me shume por me kete rast synohet qe nepermjet qellimeve, ata thjesht te detajojne vizionin).

Per te arritur qellimet PSZHSEK-ja mbeshtetet ne zhvillimin e burimeve te veta natyrore dhe njerezore. Qellimet synojne zhvillimin dhe klime per biznesin, por jo per kontrollin e tij. Zhvillimi i biznesit, pavaresisht qendrimit te qeverise lokale, eshte prosperitet. Problemi eshte ta orientosh zhvillimin e tij aty ku synon me vizionin e komunes.

Kutia nr. 10 Koncept Vizioni

Deri më 2017, Komuna do të jetë një qendër e rëndësishme ekonomike, me një sistem modern të mbrojtjes sociale, ku do të harmonizohen faktorët natyrorë e historikë, ku do të ndihen mirë e do të bashkëtojnë në harmoni gjithë grupet shoqërore, një vend për të jetuar mirë, punuar e pritur miq

II.2 SWOT Analiza e Konsoliduar (ose konkurente)

Kjo analizë është volumi më i madh i punës që duhet përballuar gjatë hartimit të Planit Strategjik sepse:

- Ashtu si në vendet e tjera të Europës Lindore edhe në Kosovë, komunat kanë shumë “halle”.
- Mundësitë e brendshme financiare janë tejte të kufizuara, por edhe ato qendrore nuk “derdhen lume”. Nga ana tjetër donatorët preferojnë të kontribuojnë aty ku numri i përfituesve është më i madh se 300-500 mijë banorë, dhe në nivel të tillë është vetëm Prishtina.
- “Padurimi” i komunitetit (mundësisht të behen të gjitha në një apo dy vjet) është i madh, aq më tepër të ballafaquara me bashkitë e vendeve të Europës Perëndimore.
- Përveç identifikimit të programeve dhe të projekteve, sikurse do ta shohim më poshtë për secilin prej tyre kërkohet “Preventivi Paraprak”, gjë që është një detyrë suplementare e pjesës teknike të bashkisë, dhe që duhet realizuar, për efekt të specifikave edhe me institucione jashtëkomunitare.

Përgjithësisht analiza SWOT mbështet në këta tregues kryesorë:

- a) **Faktorët e brendshëm:** Pikat e forta (positive), Pikat e dobëta (negative).
- b) **Faktorët e jashtëm** (për njësinë lokale): Mundësitë dhe ndikimi i tyre
- c) Rreziqet ose Kercenimet

Për t’u patur më lehtë që të ballafaqohen, elementet përberës të analizës SWOT përmbledhen në një pasqyrë (Shih Kutinë nr. 11 në vijim), në të cilën jemi përpjekur të japim edhe ndonjë shembull, thjesht për të konkretizuar idenë, ndërsa roli dhe vendi i tyre nuk përfaqësohet nga numri rendor përkatës:

Kutia nr.11 Një Model i Analizës SWOT

Faktore të brendshëm	Faktore të jashtëm	Rreziqet/Kercenimet
<u>Pika të forta (Pozitive)</u> 1. Tradita e punimit artizanal dhe tregëtisë. 2. Ekzistenca e burimeve të mëdha natyrore (cilesorë p.sh. minerarë, ujorë, pyjorë etj)	<u>Mundësitë</u> 1. Shpallja e Statusit të Kosovës. 2. Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Kosovës. 3. Prania dhe bashkëpunimi me organizatat dhe	1. Ndikimi negativ i politikave qendrore. 2. Prania e tregëtisë informale, konkurrencës së pandershme dhe evazionit fiskal 3. Ndikimi i faktorëve jo të qëndrueshëm ekonomikë
<u>Pika të dobëta (Negative)</u> 1. Paqëndrueshmëria politike		

qendrore. 2. Mungesa e plote e legjislacionit dhe mos zbatimi i egzistuesit.	fondacione te huaja (cilesore)	(inflacioni, interesi i larte i kredive bankare)
---	-----------------------------------	---

Ne analizen e faktoreve te brendeshem, natyrisht ju kushtohet kujdes zbulimit dhe evidentimit te dy faktoreve: pozitive edhe negative; por ne vemendje me te madhe duhet te jene zbulimi i pikave te dobeta (negative), sepse ndonje pike e forte edhe po nuk u evidentua, perseri vepron pozitivisht, ndonese jo ne shkallen e duhur.

Pas analizes SWOT dhe para fillimit te punes per hartimin e matricave nepermjet pytesoreve, grupet e punes organizojne nje sere testimesh per te vjele mendimin e komunitetit ose segmenteve specifike te tij, per probleme te ndryshme te cilat sherbejne si nje baze reale e perputhshmerise se nevojave te komunitetit me ato çka do te programohen dhe pasqyrohen nepermjet projekteve konkrete.

Disa nga pytesoret kryesore mund te jene:

1. Pyetesori per klimen, bashkepunimin, mundesite dhe nevojat e biznesit.
2. Pyetesori per perceptimin qe kane banoret per nje sere sherbimesh qe ju ofron komuna si furnizimi me uje, energji elektrike, pastrimi, gjelberimi, mbrojtja e mjedisit, kanalizimet e ujrave te perdorura etj.
3. Pyetesori per zhvillimin e turizmit, mundesite, resurset, traditat etj.
4. Pyetesori per nivelin e infrastruktures, ndicimit rrugor, dekorit te komunes, etj.
5. Pyetesori mbi veprimtarine e administrates komunale etj.

Gjate hartimit te pytesoreve dhe sidomos gjate intervistimeve, e rendesishme eshte qe pyetjet te jene sa me te qarta dhe koncize dhe te sigurohet pergjigja reale e te pyeturve. Nderkohe eshte e rendesishme qe te perzgjidhen mire kampionet e atyre qe do te intervistohen ne menyre qe te jene sa me perfaqesuese.

Pergjithesisht rekomandohet grupimi ne kategori te ndryshme shoqerore, me synim per te bere dallimet, sipas problemit, me synim qe grupeve te ndryshme, mund t'u ofrohen edhe zgjidhje te ndryshme, ose te shikohet influenza e projektit te parashikuar ne matrice per secilin grup. Nje model tip te hartimit te nje pyetesori te hollesishem, ju mund ta gjeni ne adresen www.wolbank.org/urban/led

Nga ana tjeter i rendesishem eshte edhe sistemi i referencave dhe i krahasimeve, me ku dhe si zhvillohen te tjeret, brenda ose jashte vendit, kuptohet qe shkalla e krahesimit duhet te zgjidhet per nivele popullsie, siperfaqe apo biznesi perafersisht te njejte (*s'mund te merren psh nivele krahesimi te komunes Gjilan me ato te bashkise se Parisit*).

Kutia nr. 12
Mbi Kuptimin e Rregulloreve dhe Vleresimin e Tyre

Ne vemendje te hartuesve te PSZHSEK-së!

Kuptimi i rregulloreve eshte i pari ne nje sere raportesh vjetore te Grupit te Bankes Boterore, duke prezantuar nje sere indikatoresh cilesor, mbi performancen e rregullimeve per biznesin te cilat mund te krahasohen ne menyre te kryqezuar me me shume se 130 vende ne çdo kohe.

Raporti siguron nje informacion te nevojshem mbi metodologjite per te vleresuar rregullimet te cilat prekin zhvillimin e biznesit, si dhe nje faqe ne web e cila eshte e bazuar ne pyetje pergjigje (<http://rru.worldbank.org/doingbusiness/>)

II.3 Matrica e Qellimeve te Planit, Objektivave, Programeve dhe Projekteve.

Ne kete matrice (MQOPP) realizohet gershetimi i Vizionit, Qellimeve qe i vihet Planit dhe Objektivave perkatese per çdo qellim, perkrah te cilit qendrojne programet dhe projektet e detajuara.

Ne pasqyren nr.2 jepet per konkretizim si realizohet ky harmonizim (*shembulli eshte hipotetik*):

Kutia nr. 13
Harmonizimi i Qellimeve te Planit, Objektivave, Programeve dhe Projekteve

VIZIONI⁶				
Deri më 2017, Komuna do te jete nje qender e rendesishme ekonomike, me nje sistem modern te mbrojtjes sociale, ku do te harmonizohen faktoret natyrore e historike, ku do te ndihen mire e do te bashketojne ne harmoni gjithë grupet shoqerore, nje vend per te jetuar mire, punuar e pritur miq.				
Qellimet	Objektivat	Programet	Projektet	Nr.
<u>Qellimi 1:</u> Komuna me nje ekonomi lokale terheqese dhe me nje biznes dinamik e te afte te operoje	Q1:O1: Rritja me 15% e numurit te subjekteve qe operojne ne komune deri ne vitin 2009. Q1: O2: rritja nga 2 ne 4 e aktiviteve bashkepunuese	Q1:O1:Pg1: Sigur cilesor i sherbimeve ne zonen e tregut. Q1: O1:Pg2: Prom i produkteve dhe bizneseve ne komune. (vazhdon detajimi i programeve	Q1:O1:Pg1:Pr1: Permiresimi i furnizimit me uje te zones se tregut.	1
			Q1:O1:Pg1; Pr2: Permiresimi i sistemit te kanalizimeve ne zonen e tregut.	2
			Q1: O1: Pg1.Pr3: Permiresimi i infrastruktur rugore ne zonen e tregut.	3
			Q1: O1: Pg.1: Pr.4: Permiresimi i ndricimit rrugor ne zonen e tregut.	4
			Q1: O1: Pg1: Pr.5: Instalimi i linjave te reja te telefonise	5

⁶ Formulim hipotetik jo fort i goditur, sepse konsiderohet i gjate, por eshte dhene per efekte metodologjike dhe perfytyrimi te qate.

sukseshem ne tregun rajonal.	n/kufitare me 2010 (vazhdojne objektivat tjera per Q1)	sipas objektivave dhe qellimeve)	fikse individuale dhe publike ne zonen e tregut.	
			Q1: O1 :Pg.:Pr6 : Permiresimi i sherbimit urban ne zonen e tregut.	6
			Q1:O1:Pg.: Pr7: Shtimi i zones se gjelber dhe mbjellja e 500 cope drureve decorative ne zonen e tregut.	7

Pra, sikurse duket dhe nga ky shembull hipotetik, per nje qellim te caktuar, planizohen gjithë programet dhe projektet e nevojshme me qellim qe te arrihet kondicioni me i mundeshem cilesor. Keshtu, sikunder duket, vetem per programin e pare te objektivit te pare ne funksion te qellimit te pare parashikohen 7 projekte.

II.4 Matrica e Zbatimit te Planit

Pas hartimit te matrices se qellimeve, objektivave, programeve dhe projekteve perkatese hartohet matrica e zbatimit te Planit Strategjik (MZ), e cila si te thuash eshte kostoja e çdo projekti dhe shtrirja kohore e realizimit si dhe perfituesit, e MQOPP-se. Duke vazhduar shembullin hipotetik te siper permendur, reflektimi ne MZ, jepet ne pasqyren Nr.1 ne vijim.

Pasqyra Nr.1
Model Mbi llogaritjen e Kostos se çdo Projekti (ne 000/Euro)

Nr. Pr	Titulli Projekt	Vlefta	Burimet e financimit				Zbatimi			Statusi	Gr.Synuar
			QQ	Komun	Qytet	Donatotet	Part	Fi	Fu		
1	Permiresimi i furnizimit me uje te zones se tregut.	440	130	20	0	280	OBK	'07	O9	F	Qytetaret / Biznesi

Ne kete menyre hap pas hapi, perpilohet matrica e plote, dhe mbi kete baze del edhe kostoja e zbatimit te gjithë Planit Strategjik.

II.5 Matrica e Prioritarizimit te Projekteve

Rradha e zbatimit te projekteve te identifikuara, ose prioritarizimi i projekteve mund te ndjeke kete rruge:

- Çdo grup pune ben prioritarizimin e projekteve te identifikuara nga vete grupi, ose
- Per te perjashtuar "ndikimin", prioritarizimi i projekteve te nje grupi i kalon nje grupi pune tjeter,
- Komisioni me antaret e perhershëm, ben me po te njejten menyre edhe matricen permbledhese te prioritarizimit te gjithë projekteve, sipas ofertes se secilit grup.

Para se te fillojne procedurat, anetaret e grupeve te punes dhe Komisionit te perhershëm, trajnohen mbi metodologji qe do te perdoret per prioritarizimin e

projekteve. Ka disa metoda prioritarizimi te projekteve por me si me efikase ne rekomandojme metoden e meposhtme:

Pergjithesisht kalohet ne keto **3 etapa baze**:

1. Percaktimi i koeficientit te nevojës.
2. Percaktimi i koeficientit te fizibilitetit
3. Percaktimi i koeficientit te projektit

Per percaktimin e koeficientit te nevojës, ne grupin e punes ndiqet kjo rradhe pune:

- a) Percaktoni shkallen per koeficientin e vleresimit (psh nga 0 ne 10)
- b) Hartoni formularin e nevojës
- c) Gruponi projektet sipas qellimeve
- d) Kategorizoni projektet, brenda çdo grupi te qellimeve , si te forta(F) ose te buta(B)
- e) Renditni ne formularin e nevojës, te gjithë projektet sipas numurit te grupit dhe kategorise se vleresimit te mesiperm me **F** apo **B**
- f) Paisni pjesmarresit e grupit te punes me **formularin e nevojës dhe jepni per ta udhezimin e nevojshem**: Anetareve te grupit te punes u kerkohet te vleresojne projektet, brenda sejcilit grup, si **te domosdoshem(d)**, **te nevojshem(n)** dhe **me pak te nevojshem(pn)**. Pra cdo anetar i grupit te punes ne vleresimin e tij mund te perzgjedhe vetem **tre** projekte brenda çdo grupimi projektësh, per secilin vleresim paraprak qe eshte bere ne **F** dhe **B** (kuptohet qe kur numuri i projekteve brenda grupimit eshte i vogel, vleresimi **d, n, pn** mund te ulet per dy ose nje projekt)

Per percaktimin e koeficientit te fizibilitetit, ndiqet kjo rradhe pune:

- a) Sqaroni kriteret e koeficientit te vleresimit te fizibilitetit :
 1. Kriteri i pare: burimi i financimit i siguruar? (Po **0**, Jo **0.1**)
 2. Kriteri i dyte: Identifikimi i numurit te burimit te financimit **te mundshem** (≥ 2 , 01, 0.1 ; 0, 0.2)
 3. Kriteri i trete: a e ka komuna mundesine (kapacitetin njerezor) per te zbatuar projektin? (po, 0; ndoshta, 0.1; jo, 0.2)
 4. Kriteri i katert: A ka patur komuna, ne menyre te sukseseshme, nje projekt te ngjashem me pare? (po,); jo, 0.2)
 5. Kriteri i peste : Shkalla e rrezikut (0,0; 1 ose 2, 0.1; >2 , 0.2)
 6. Kriteri i gjashte: Percaktimi i grupeve te popullates te synuara (perfituesit) si me poshte: gjithë popullata, **0**; segmente specifike te populates, **0.1**; nje popullate specifike jo-prioritare, **0.2**.
 7. Kriteri i shtate: Numuri i Qellimeve/Objektivave te adresuara prej projektit (≥ 3 , 0; <3 , 0.1)
- b) Mblidhni rezultatet e ne çdo rresht per te krijuar **koeficientin e fizibilitetit (kf)** per çdo projekt.
- c) Vendosni **kf** ne pasqyren e prioritarizimit te projekteve (shih me poshte).

Per rezultatin e prioritarizimit te projekteve, ndiqet si me poshte:

- a) Listoni çdo projekt sipas vleresimit i forte (**F**) ose i bute (**B**)
- b) Percaktoni kohezgjatjen e zbatimit te projektit sipas vleresimit: afatgjate (**aGJ** >3 vjet); afatmesem (**aM** 1-3 vjet); afatshkurter (**aSh** <1 vit)

- c) Madje per çdo projekt **pjestohet** koeficientin e nevojës(kn) me koeficientin e fizibilitetit (kf) per te perfituar **Rezultatit e Prioritetit (RP)**
- d) Listoni renditjen e projekteve sipas **RP** nga ai me vlere me te larte tek ai me vlere te RP-se me te ulet.
- e) Listoni renditjen perfundimtare te prioritetive te projekteve, duke perfshire shkurtime e nevojshme te percaktuara per kategorizimet i forte dhe i bute si dhe kohen e zbatimit te tyre.

Listimi perfundimtar reflektohet ne pasqyren tip, siç tregohet ne Pasqyren nr.2 (emertimet e kodeve dhe titujve te projekteve jane hipotetike):

Pasqyra nr. 2
Pasqyre Tip Mbi Listimin e Prioriteve te Projekteve

Nr.i Prior	Kodi i Projk	Nr.i Projk	Titulli i Projektit	Forte/Bute	Burim fondesh identifik ⁷	Fond I Sigurt	Kapaci Komun P/N/J ⁸	Zbatuar mepare	Numuri i risqeve	Grupet e shtuar	Plots i qellimeve
1	Q5:O3:Pg1:Pr1	64	Hartimi i "Guida Turistike" te Komunes	F	L	Po	N	Jo	U	P	3
2	Q1:O1:Pg.1:Pr4	4	Permiresimi i ndriçimit rrugor ne zonen e tregut.	B	M	Po	P	Po	U	P	2
3	Vijon listimi										

II.6 Projekt Fishat

Çdo projekt ka fishen e vet ne te cilen pasqyrohen detaje te secilit projekt, sipas shembullit qe paraqitet me poshte:

Pasqyra nr. 3
Pasqyre Tip Mbi Fishen e Detajuar te Projekteve

Nr 1	Projekti Q5 : O3 : Pg.1 : Pr.1 : Hartimi i "GUIDA TURISTIKE" e Komunes _____	Tipi i programit Q5 : O3 : Pg.1 : Sigurimi cilesor i sherbimeve dhe infrastruktures publike ne qytet per ta bere ate terheqes nga pikpamja turistike.
-------------	--	---

⁷ L-latrite, M-mesatar; U-ulet

⁸ Kapaciteti njerezor i komunave : P-po; N-ndoshta; J-jo

⁹ P-pergjitheshem; S-specificik; V-vogel

Pershkrimi i shkurter i projektit Komuna jone ka resurse te plota turistike natyrale dhe te krijuara prej punes se njeriut. Disa prej tyre siç jane xeheroret polivalente te minieres, jane te rralla ne rajonin e Ballkanit dhe me gjere. Tashme ne kemi nje muzeum specifik per to qe ruan mbi 10 mije ekzemplare xeheroresh me madhesi, perberje dhe ngjyra te ndryshme. Komuna jone ruan vlera te veçanta edhe nga pikepamja e ndertimit te kullave tradicionale, paçka se disa prej tyre jane te pabanuara dhe ne rrenim e siper. Parku natyror qe eshte vetem 5 kilometra larg nga qyteti, perben vlera te veçanta shlodhese, kurative dhe mjedisore. Por te gjitha keto pak njihen jashte komunes sone. Prandaj del e domosdoshme te hartojme “ Guiden Turistike ” te komunes sone, si nje udherefyes per çdo te ardhur ne komune qofte ose jo per qellime turistike.	
Rezultatet e pritshme Promocion me i organizuar dhe i drejperdrejte i vlerave turistike te komunes sone. Rritje e interesit turistik per Komunen.	Grupet e synuara Komuniteti ne teresi, biznesi
Aktoret e Mundeshem Agjensia Rajonale e Zhvillimit Oda e Biznesit ne Komune(OBK) 3 Agjensite turistike ne Komune	Kontribuesit e mundeshem Oda e Biznesit ne Komune Agjensite Turistike “Jezerca” dhe “Kosova-Tours”/GTZ
Para Kushtet Marreveshje paraprake me OBK, dhe Agjensite Turistike per shperndarjen e Guides	Faktoret riskues Negociata te dobeta midis DKZH-Komune dhe Agensive Turistike.
Shpenzimet e llogaritura:	
1. Konceptomi i guides	3 000 Eu
2. Fotografimet	2 000 Eu
3. Botimi ne leter per 1000 kopje	5 500 Eu
4. Botimi ne CD per 500 kopje	1 500 Eu
Totali	12 000 Eu
Personi i Kontaktit per projektin: Rexhe Ismajli ¹⁰ - Administrata e Komunes	
Periudha e Zbatimit Deri ne botim 5 muaj; botimi 2 muaj; gjith.7muaj	Periudha e pritjes se rezultatit Shumevjeçar

Sipas ketij modeli pergatiten fishat per te gjithë projektet e miratuara.

¹⁰ Çdo ngjashmeri me emra personash konkrete eshte krejt e rastit (Shenim i Autorit)

Pjesa e III-te:

BASHKERENDIMI DHE KORDINIMI I PLANIT STRATEGJIK TE ZHVILLIMIT EKONOMIKO-SOCIAL TE KOMUNES.

Nje plan i qendrueshem, i realizueshem dhe efektiv sigurohet ne se ai bashkerendohet me faktoret e tjere qe ndikojne ne zhvillimin e komunes. Nder to me kryesoret do te permendnim:

III.1 Bashkerendimi me Planin Kombetar te Zhvillimit

